



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRI I SHTETIT
PËR DIASPORËN**

Nr. 5621/6 Prot, Datë 2.12.2019

**MINISTRIA E FINANCAVE DHE
EKONOMISË**

Nr.21282 Prot, Datë 2.12.2019

**MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI
PËR
KRYERJEN E SHËRBIMIT TË AUDITIMIT TË BRENDSHËM**

Në funksion të mirëqeverisjes, krijimit të një sistemi të kontrollit të brendshëm efektiv me qëllim administrimin ligjor të aseteve dhe informacionit financiar e operacional, si dhe mbrojtjen e interesave financiarë të njësisë publike kundrejt parregullsive apo veprimeve që çojnë në kryerjen e veprave penale, palët bien dakort të lidhin këtë marrëveshje, si më poshtë:

Neni 1

Kjo marrëveshje bashkëpunimi rregullon kushtet, të drejtat, detyrimet dhe format e bashkëpunimit ndërmjet Ministrit të Shtetit për Diasporën, si përfitues i shërbimit të auditimit të brendshëm për institucionet e vartësisë dhe Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, si ofruese e shërbimit të auditimit të brendshëm.

Neni 2

Marrëveshja e bashkëpunimit është hartuar në bazë të germë 'c', të pikës 1, të nenit 10 të ligjit nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik" dhe VKM-së nr.83, date 03.02.2016 "Për miratimin e kriterëve të krijimit të njësisë të auditimit të brendshëm në sektorin publik" i ndryshuar.



Neni 3

Shërbimi i auditimit të brendshëm do të kryhet në përputhje me:

- Ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".
- Standardet ndërkombëtare për praktikën profesionale të auditimit të brendshëm.
- Kodin e etikës për audituesit e brendshëm në sektorin publik, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 86, date 10.12.2015.
- Kartën e auditimit të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 11, date 06.02.2017.
- Manualin e auditimit të brendshëm, miratuar me urdhër të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 100, date 25.10.2016.
- Urdhrin e Ministrit të Financave dhe Ekonomisë nr. 98, date 21.09.2017 "Për sigurimin e brendshëm të cilësisë së njësisë së auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë".
- Udhërrëfyesin e auditimit të brendshëm të Drejtorisë së Auditimit të Brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Neni 4

Termat e përdorur në këtë marrëveshje bashkëpunimi kanë të njëjtin kuptim me ato të parashikuara në ligjin nr. 114/2015 "Për auditimin e brendshëm në sektorin publik".

Neni 5

Pala përfituese e shërbimit të auditimit të brendshëm pranon të verë në dispozicion të palës sipërmarrëse të shërbimit të auditimit të brendshëm të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, që kërkohet për përgatitjen dhe kryerjen e misionit të angazhimit të auditimit të brendshëm si:

- a) Të gjithë të dhënat me karakter teknik, ekonomik e financiar dhe menaxherial, në funksion të hartimit të një programi angazhimi me qëllim kryerjen e shërbimit të auditimit të brendshëm në përputhje me



kuadrin ligjor dhe rregullativ në fuqi, si dhe me standardet ndërkombëtare dhe praktikat me të mira të auditimit të brendshëm.

- b) Të sigurojë kushtet e nevojshme të punës për grupin e auditimit, zyre dhe pajisje logjistike të përshtatshme për këtë shërbim në mjediset e palës përfituese, si dhe akses të plotë në ekzaminimin e dokumentacionit në çfarëdo forme që ai mbahet, si: (manuale apo me sistem informatikë), si dhe komunikim me të gjithë drejtuesit dhe punonjësit e strukturave organizative të palës përfituese.
- c) Të hartojë, miratojë dhe ndjekë planin e veprimit, për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procedurave të auditimit nga njësia e auditimit të brendshëm, brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar.
- d) Të kërkojë planifikimin e auditimit të brendshëm, sa herë që vlerëson me risk një sistem apo program të institucionit të vet

Neni 6

Pala ofruese e shërbimit të auditimit të brendshëm merr përsipër:

- a) Të mbështesë njësinë publike për arritjen e objektivave të saj duke:
 - ndihmuar titullarin dhe nivelin tjetër drejtues që të identifikojë, vlerësojë dhe menaxhojë risqet;
 - të vlerësojë përputhshmërinë e akteve dhe të kontratave me legjislacionin; të kryejë veprimtarinë e organizatës dhe përdorimin e fondeve me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet.
- b) Të vlerësojë përshtatshmërinë dhe efektivitetin e sistemeve e të kontrolleve, duke u fokusuar kryesisht në:
 - Identifikimin, vlerësimin dhe menaxhimin e riskut nga titullari i njësisë publike;
 - Përputhshmërinë e veprimtarisë së njësisë publike me kuadrin rregullator;
 - Ruajtjen e aseteve;
 - Besueshmërinë dhe gjithë përfshirjen e informacionit financiar dhe operacional;
 - Kryerjen e veprimtarisë së njësisë publike me ekonomi, efektivitet dhe efikasitet



- Përbushjen e detyrave dhe arritjen e qëllimeve;
- c) Të ofrojë shërbimet e sigurisë ose shërbimeve të konsulencës kur një gjë e tillë kërkohet pala përfituese.
- d) Të kryejë angazhimin e auditimit në përputhje me programin dhe me standardet e auditimit të brendshëm, duke marrë përsipër ruajtjen e fshehtësisë sipas legjislacionit në fuqi.
- e) Të japë rekomandime për përmirësimin e veprimtarisë dhe efektivitetin e sistemit të kontrollit të brendshëm të njësisë publike.
- f) Të ndjekë zbatimin e rekomandimeve të dhëna.

Neni 7

Në përfundim të një angazhimi auditimi, drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm i dërgon subjektit të audituar raportin e auditimit së bashku me rekomandimet, të cilat vendosen në formën e planit të veprimit.

Neni 8

1. Subjekti i audituar brenda 30 ditëve nga data e dorëzimit të raportit përfundimtar, harton dhe miraton planin e veprimit për zbatimin e rekomandimeve të lëna në përfundim të procesit të auditimit.
2. Plan i veprimit i miratuar nga subjekti i audituara, dërguar njësisë së auditimit të brendshëm përmban :
 - a. Rekomandimet;
 - b. Riskun;
 - c. Referencën e raportin e auditimit;
 - ç. Reagimin e menaxhimit në lidhje me rekomandimet;
 - d. njësinë apo personat përgjegjës për realizimin e rekomandimeve;
 - dh. Afatin e zbatimit të rekomandimeve;
3. Në rast të mos pranimit të rekomandimit, subjekti i audituar përveç shënimit në kolonën përkatëse të planit të veprimit, duhet të argumentojë arsyet e refuzimit për zbatimin e rekomandimit, duke:
 - a. vendosur referencat ligjore;
 - b. Arsyet objektive dhe subjektive;
 - c. Analizën e raportit kosto/përfitim;
 - ç. Juridiksionin funksional.



Neni 9

1. Njësia e auditimit të brendshëm, në do rast kur informohet lidhur me mos pranimin e rekomandimeve nga subjekti i audituar apo mos zbatimin e rekomandimeve të pranuara, informon menjëherë Titullarin e subjektit të audituar. Informacioni përveç statusit të rekomandimit duhet të përmbajë edhe riskun e pranuar nga subjekti i audituar, argumentin e dhënë prej tij dhe vlerësimin e auditueseve lidhur me papranueshmërinë e riskut dhe kostot apo efektet që mund të ndodhin nga mos zbatimi.
2. Në rast se Titullari i subjektit të audituar vlerëson pozitivisht dobinë e rekomandimit të dhënë nga audituesit, ndjek rrugën administrative për zbatimin e tij. Rruga administrative ndiqet nëpërmjet hierarkisë institucionale dhe nuk është detyrim i njësisë së auditimit të brendshëm.

Neni 10

1. Njësia e auditimit të brendshëm, monitoron dhe ndjek zbatimin e rekomandimeve të pranuara nga subjekti i audituar, nëpërmjet:
 - a. raportimeve të subjektit të audituar, sipas kërkesës së njësisë së auditimit të brendshëm;
 - b. shqyrtimit dhe vlerësimit të statusit të rekomandimeve, në auditimin e rradhës;
 - c. këqyrjes në vend të statusit të rekomandimeve.
2. Këqyrja e zbatimit të rekomandimeve të kryhet me program pune të miratuar nga drejtuesi i njësisë së auditimit të brendshëm, kur:
 - a. subjektet e audituara nuk kanë raportuar për statusin e rekomandimeve
 - b. auditimi i rradhës planifikohet të kryhet më shumë se një vit nga dhënia e rekomandimeve;
 - c. status i rekomandimit kërkon informacion dhe analizë shtesë.

Neni 11

Brenda datës 15 Shkurt të çdo viti, njësia e auditimit të brendshëm përgatit raportin vjetor, i cili i dërgohet strukturës përgjegjëse për harmonizimin e auditimit të brendshëm në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, ku ndër të



tjera përmban të dhënat lidhur me veprimet e ndërmarra nga subjekti i audituara gjatë vitit për zbatimin e rekomandimeve, si dhe çdo rekomandim të pazbatuar.

Neni 12

1. Marrëveshja e bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit të saj nga palët dhe i shtrin efektet deri më 31.12.2021
2. Palët mund të zgjidhin këtë marrëveshje nga efektet në do kohë, duke njoftuar paraprakisht palën tjetër.

Neni 13

Marrëveshja e bashkëpunimit mund të ndryshohet në çdo kohë nga palët. Çdo ndryshim apo amendim i kësaj marrëveshje është i vlefshëm vetëm nëse bëhet me shkrim dhe nënshkruhet nga palët.

Neni 14

Mosmarrëveshjet apo paqartësitë që mund të lindin në kuadër të zbatimit të kësaj marrëveshje bashkëpunimi zgjidhen me mirëkuptim nga palët.

Neni 15

Kjo marrëveshje përpilohet në gjuhën shqipe dhe mbahet në 3 (tre) kopje të barasvlefshme, të cilat pasi nënshkruhen nga palët, 2 (dy) i merr pala përfituese e cila 1 (një) kopje e dërgon tek struktura përgjegjëse e harmonizimit për auditimin e brendshëm, dhe 1 (një) e merr pala sipërmarrëse e shërbimit të auditimit të brendshëm.

**Për Ministrin e Shtetit
për Diasporën**

Pandeli Majko

MINISTËR

**Për Ministrinë e Financave
dhe Ekonomisë**

Anila Denaj

MINISTËR